

VENDIM
Nr.215, datë 11.2.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.933, DATË 2.7.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFAQËSIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME ME
OFICERË KONTAKTI NË BRITANINË E MADHE, BELGJIKË, ITALI, GREQI,
TURQI, KOSOVË DHE EUROPOL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.933, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti, në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermani, Francë dhe EUROPOL”.

b) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti, pranë ministrive homologe, në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermani, Francë, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, për të mbështetur luftën e përbashkët kundër trafikut ndëkombëtar të lëndëve narkotike, terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të armëve, emigracionit të paligjshëm dhe pastrimit të parave.”.

c) Pika 3 shfuqizohet.

ç) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Ministri i Brendshëm përcakton numrin e oficerëve të kontaktit sipas pikave 1 e 2 të këtij vendimi, të cilët mund t'i ngarkojë për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme në më shumë se 1 (një) vend.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha